



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 06.05.2016, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, nënkryetar, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shaip Shabani (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Laura Zherka (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Abit Kastrati, Mirlinda Sopi (AKR), Sami Boroci (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik GIS dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci (PDK), Genc Sherifi (LVV), dhe Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.
Kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Për rendin e ditës diskutuan: Lirak Çelaj, Flamur Shala, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Shefki Gashi, Qëndron Kastrati, Sami Hamiti, Feti Mehdiu dhe Ibrahim Mehmetaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës. Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 40 vota për, u miratua ky

R E N D D I T E :

- 1. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;**
- 2. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për vazhdimin e afatit shtesë për lirin e hapësirave nga AKP-ja.**

Pika e parë

Kryesuesi e hodhi në votim Propozimvendimin për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se me 40 (dyzet) vota për, u miratua Vendimi për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Cuneyd Ustaibo (KDTP) ka paraqitur kërkesën për dorëheqje prej anëtarit të Kuvendit, dhe në grupin punues në vend të tij do të emërohet anëtari i radhës nga Partia Turke.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Prishtinës, kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se me 40 (dyzet) vota për, u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Prishtinës.

Pika e tretë

Kryesuesi e hodhi në votim Propozimvendimin për vazhdimin e afatit shtesë për lirimin e hapësirave nga AKP-ja.

Kryesuesi konstatoi se me 40 (dyzet) vota për, u miratua Vendimi për lirimin e hapësirave nga AKP-ja.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45

**Procesmbajtësja
Luljeta Selimi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.**